# Sistemi arsimor –<br>i depërtueshëm dhe i rrjetëzuar




Rrugët e drejpërdrejta të ngritjes dhe arsimit

Këto rrugë të arsimimit (vijat e ndërprera) janë vetëm pjesërisht ose jo drejtpërdrejtë të realizueshme. Ose lejohet regjistrimi në drejtime të caktuara ose kërkohet një praktikë profesionale, një Pasarelle, një praktikë, një kurs përgatitor, një provim plotësues ose të ngjashme.

## Nuk ka përfundim pa lidhje

Sistemi arsimor në Zvicër është i rrjetëzuar dhe i depërtueshëm. Pas shkollimit të obligueshëm ju mund të filloni karrierën profesionale me arsimime të ndryshme, t'i caktoni vetes qëllime të reja dhe t'i arrini ato me arsimime të mëtejme.

Çdo hap i arsimimit shpie në një përfundim, dhe çdo përfundim garanton një kalim në një hap tjetër më të avansuar të arsimimit. Sot është më pak e rëndësishme se cilin hap të arsimimit ose cilin profesion e zgjidhni. Shumë më e rëndësishme është, se si i shfrytëzoni mundësitë dhe shanset.

Në këtë skemë janë paraqitur vetëm rrugët më të rëndësishme. Ka edhe shumë rrugë dhe veçanti të tjera. Pyetni këshilltarin tuaj personal nga Këshillimorja Profesionale.